



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE

Nr. 4777 prot

Tiranë, më 30.09.2025

V E N D I M

Nr. 2, datë 30.09.2025

PËR ZGJEDHJEN E Z. ASIM VOKSHI ANËTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| 1. Sokol Sadushi | Kryetar; |
| 2. Ilir Panda | Anëtar; |
| 3. Ervin Pupe | Anëtar; |
| 4. Medi Bici | Anëtar; |
| 5. Sokol Binaj | Anëtar; |
| 6. Albana Boksi | Anëtare; |
| 7. Sandër Simoni | Anëtar; |
| 8. Artur Kalaja | Anëtar; |
| 9. Arbena Ahmeti | Anëtare; |
| 10. Margarita Buhali | Anëtare; |
| 11. Gentian Medja | Anëtar; |
| 12. Sokol Ngresi | Anëtar; |
| 13. Enton Dhimitri | Anëtar; |
| 14. Enkelejda Metaliaj (Softa) | Anëtare; |
| 15. Valbon Çekrezi | Anëtar; |

Në mbledhjen e datës 30.09.2025, e cila ka në rend të ditës zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, që është në emërtesë të saj,

VËREN:

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj, që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit shpalli në datën 11.12.2024 thirrjen e shprehjes së interesit për të kandiduar në këtë pozicion.
3. Lista e kandidatëve që aplikuan së bashku me dokumentacionin shoqërues iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organi që kryen verifikimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.
4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 23.09.2025, depozitoi në Gjykatën e Lartë listën e renditjes së kandidatëve së bashku me raportin e renditjes së kandidatëve dhe dokumentacionin përkatës. Në listën e renditjes së kandidatëve, z.Asim Vokshi është renditur i pari me 89.5 pikë, zj.Naureda Llagami është renditur e dyta me 89.3 pikë, ndërsa z.Florian Ballhysa është renditur i treti me 77.83 pikë.
5. Me vendimin nr.1, datë 25.09.2025, Kryetari i Gjykatës së Lartë vendosi thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese më datë 30.09.2025.
6. Mbi bazën e vendimit nr. 1, datë 24.02.2022, "*Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese*", si dhe referuar listës së kandidatëve dhe renditjes së tyre nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. 220, datë 25.09.2025, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me kandidatët: Asim Vokshi, Naureda Llagami dhe Florian Ballhysa, sipas renditjes së përcaktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
7. Në datën 30.09.2025 u zhvillua Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku morën pjesë 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke plotësuar kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë Asim Vokshi, për shkak se është në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mori pjesë në mbledhje, ndërsa gjyqtarja Vojsava Kola nuk mori pjesë për arsye shëndetësore.
8. Referuar Rregullores së Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, procesi i votimit u administrua nga komisioni i posaçëm i votimit, i miratuar për këtë qëllim nga Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve, në përbërje të të cilit janë: kancelari i Gjykatës së Lartë, kryesekretari dhe një sekretar gjyqësor.
9. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni, pas numërimit të fletëve të votimit, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët: z.Asim Vokshi mori 6 (gjashtë) vota, zj. Naureda Llagami mori 8 (tetë) vota, z. Florian Ballhysa nuk mori 0 (zero) votë, ndërsa 1 (një) votë u shpall e pavlefshme.

10. Referuar nenit 7/ç, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili parashikon se kandidati fitues duhet të sigurojë një shumicë prej 3/5 të votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe, në kushtet kur asnjëri prej kandidatëve nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të nevojshme, kandidati që është i pari në listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të hartuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, konsiderohet *ipso lege* i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 125, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 7/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), bazuar në rezultatet e votimit të zhvilluar në datën 30.09.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e z. Asim Vokshi anëtar të Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9 vjeçar.
2. Ky vendim i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
3. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Artur Kalaja
Anëtar

Ilir Panda
Anëtar

Sokol Sadushi
Kryetar

Albana Boksi
Anëtare

Sokol Binaj
Anëtar

Ervin Pupe
Anëtar

Medi Bici
Anëtar

Sokol Ngresi
Anëtar

Sandër Simoni
Anëtar

Gentian Medja
Anëtar

Enton Dhimitri
Anëtar

Arbena Ahmeti
Anëtare

Margarita Buhali
Anëtare

Enkelejda Metaliaj (Softa)
Anëtare

Valbon Çekrezi
Anëtar

